

Datë 30/01/2022

KALLZIM PENAL

KALLZUES:

A.F. Luftëtari

Përfaqësuar nga z. Fotis Kristidhi (Administrator) dhe z. Nertil Nebiaj (Anëtar i Bordit), në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të subjektit anëtar të SHRFGJ-së.

ME OBJEKT:

Kallëzim i veprave penale të “*Falsifikimi i dokumentave*”, “*Shpërdorim detyrë*”, “*Ndërhyrje në sisteme kompjuterike*” dhe “*Falsifikimi kompjuterik*” parashikuar nga nenet 186, 248, 293-c, 186-a të Kodit Penal.

KUNDËR:

Z. Ilir Shulku, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit.

Z. Sadik Sadikaj, me detyrë Kryetar i Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 280, 283 të K.Pr.Penale dhe neni 186, 248, 293-c, 186-a i Kodit Penal.

DREJTUAR:

Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
Drejtorisë Vendore së Policisë së Shtetit Gjirokastrë.

PËR DIJENI:

Prokurorisë së Përgjithshme.

I nderuar Z. Prokuror!

I nderuar Drejtor i Policisë Vendore Gjirokastrë!

Bazuar në nenet 280 dhe 283 të K.Pr.Penale parashtrijmë këtë kallëzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

RRETHANAT E FAKTEVE

Kallëzimi mbështetet në veprimet e kundraligjshme të ndërmarra nga shtetasi Ilir Shulku me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit, shtetasit Sadik

Sadikaj me detyrë Kryetar i Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë, në procedurën e zgjedhjes së delegatëve, në cilësinë e përfaqësuesve të Shoqatës Rajonale të Futbollit të Gjirokastrës, në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së. Kallzimi penal paraqitet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në kushtet kur kemi të bëjmë me vazhdimësinë e një aktiviteti kriminal të ndërmarrë nga Drejtues të Federatës Shqiptare të Futbollit Tiranë, në bashkëpunim me Kryetar të Shoqatave Rajonale të Futbollit në përzgjedhjen e delegatëve, me qëllim ndikimin apo paracaktimin e rezultatit të zgjedhjeve që do zhvillohen nga Asambleja e Përgjithshme e FSHF-së, me datë 2 Mars 2022.

Veprimtaria e kundraligjshme është iniciuar fillimisht nga zyrat e FSHF-së, nëpërmjet dërgimit të emailleve për thirrjen e mbledhjeve të Shoqatave Rajonale të Futbollit, duke ndërhyrë në të dhënat kompjuterike të shoqatave rajonale, duke vijuar më tej në përcaktimin e procedurave, si dhe duke ndikuar në rezultatin e Asamblesë së Shoqatave Rajonale. Gjithashtu theksojmë faktin se kjo veprimtari kriminale është paraprirë nga një tjetër procedurë e paligjshme, pasi ekzistojnë dyshime të arsyeshme në lidhje me vendimarrjen e Komisionit të Verifikimit pranë FSHF-së, konkretisht në lidhje me vendimin Nr. 1, datë 10.01.2022, *“Për Verifikimin e Numrit të Delegatëve për Futbollin Profesionist, Shoqatat Rajonale dhe Shoqatat e Profesioneve të lidhura me Futbollin në Asamblenë e Përgjithshme të Zakonshme Zgjedhore të FSHF-së”*. Cmojmë se ekzistojnë dyshime të arsyeshme për ndikim të jashtëligjshëm në procesin e zgjedhjes së Kreut të FSHF-së, me qëllim paracaktimin e rezultatit, pasi në disa shoqata rajonale para procesit zgjedhor, është shtuar numri i delegatëve dhe në disa prej tyre është reduktuar, pa asnjë shkak të ligjshëm, në kundërshtim flagrant me parashikimet e Statutit dhe Rregullores së Përgjithshme të FSHF-së. Kërkojmë kryerjen e veprimeve hetimore në lidhje me procedurën ligjore të ndjekur nga Komisioni i Verifikimit, për caktimin e numrit të delegatëve të Shoqatës së SHRFK-së. Në zbatim të parashikimeve ligjore të nenit 76 të K.Pr.Penale, vlerësojmë se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, është autoriteti kompetent për hetimin e kësaj çështje penale.

Në vijim Ju parashtrojmë në mënyrë përmbledhëse rrethanat e faktit e vertetuar me prova mbështetëse, konkretisht:

Rezulton se me datë 29.01.2022, rreth orës 13:00, ka qenë planifikuar të zhvillohej mbledhja e anëtarëve Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë, për zgjedhjen e 4 delegatëve që do të përfaqësojnë SHRF Gjirokastrë në Asamblenë e Përgjithshme të FSHF-së, e parashikuar të mbledhet me datë më 2 Mars 2022. Ju bëjmë me dije se Shoqata Rajonale e Futbollit Gjirokastrë përbëhet nga 9 anëtarë (persona juridik). Mbledhja përkatëse nuk është arritur të realizohet, pasi shoqata nuk ka pasur autorizim nga Bashkia Gjirokastrë për të zhvilluar mbledhjen në ambientet e stadiumit, si dhe nuk ka pasur kourumin e nevojshëm të anëtarëve të shoqatës, të përcaktuar në parashikimet statutores.

Por me shkresën Nr. 30 Prot, datë 29.01.2022, Kryetari i Shoqatës z. Sadik Sadikaj, informon anëtarët e shoqatës në lidhje me mbledhjen e zhvilluar me datë 29.01.2022, ora 13:00, sipas rendit të ditës, në ambientët e stadiumit “Luftëtari” Gjirokastrë. Në njoftim citohet fakti se mbledhja është bërë, por në kushtet kur nuk kishte kourum pasi janë paraqitur 4 nga 9 anëtarët, mbledhja është shtyrë për me datë 30.01.2022, ora 10:00, planifikuar për t’u zhvilluar në ambientet e hotel “Number one”, Gjirokastrë.

Theksojmë faktin se në njoftimin e dërguar anëtarëve të SHRFGJ-së, nga Kryetari i Shoqatës z. Sadik Sadikaj, janë pasqyruar rrethana të rreme, me pasojë falsifikimin e aktit dhe ky shtetas duhet të ngarkohet me përgjegjësi penale. Pasi me datë 29.01.2022, nuk është zhvilluar asnjë mbledhje, nuk është kryer asnjë verifikim në lidhje me kourumin, si dhe nuk është marrë asnjë vendim nga anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të SHRFGJ-së. Pasi anëtarët legjitim të shoqatës kanë njoftuar paraprakisht, mospjesmarrjen në mbledhjen e asamblesë.

Rezulton se nëpërmjet deklaratës noteriale Nr. 82 Rep, Nr. 33 Kol, datë 27.01.2022, përfaqësuesit e 9 anëtarëve legjitim të Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë, i kanë bërë thirrje organeve të FSHF-së, për transparencë në lidhje me vendimmarrjen dhe veprimet e saj proceduriale që kanë të bëjnë me organizimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e delegatëve të Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së. Duke evidentuar faktin se vendimet e marra dhe veprimet procedurale të kryera, deri më tani, nga FSHF-ja dhe disa SHRF, në lidhje me organizimin e zgjedhjeve për caktimin e delegatëve në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së të pavlefshme dhe të marra në kundërshtim dhe mosrespektim të rregullave të parashikuara në Statutin e SHRF-së dhe Rregulloren e Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së.

Në deklaratën noteriale përkatëse, anëtarët legjitim të Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë, ndër të tjera shprehin se: *“Deklarojmë vendimmarrjen tonë respektive, për revokimin e menjëhershëm të çdo akti të nënshkruar deri më sot nga ana jonë si përfaqësues ligjor të subjekteve anëtare Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë, për caktimin e delegatëve në punimet e Asambleve të Përgjithshme të SHRFK të datës 27.01.2022; duke konsideruar çdo vendim apo veprim të mëtejshëm procedural të marrë nga këta delegatë, si një vendim apo veprim absolutisht i pavlefshëm, në mungesë të tagrave përkatëse përfaqësuese dhe të dënueshëm penalisht. Ne përfaqësuesit ligjor të subjekteve anëtare të Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë jemi të vetmit përfaqësues ligjor me tagra të plota përfaqësimi në mbledhjet që do të zhvillohen nga Asambleja e Përgjithshme të SHRFK-së dhe në mbledhjet që do të zhvillohen nga Asambleja e Përgjithshme e FSHF-së”*.

Nëpërmjet deklaratës noteriale, anëtarët legjitim të Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë, kanë njoftuar paraprakisht mospjesmarrjen në mbledhjen Asamblesë së Përgjithshme të SHRFK-së, planifikuar për t’u zhvilluar me datë 29.01.2022, si dhe kanë

revokuar cdo autorizim pjesmarrje të anëtarëve të personave juridik respektiv. Pasi janë konstatuar një sërë shkeljesh ligjore dhe mungese absolute transparence në organizimin e mbledhjes së SHFRK-së, për shkak se nuk janë vënë në dispozicion paraprakisht lista e anëtarëve të shoqatës me të drejtë vote.

Ritheksojmë faktin se me shkresën Nr. 30 Prot, datë 29.01.2022, Kryetari i Shoqatës z. Sadik Sadikaj, informon anëtarët e shoqatës në lidhje me mbledhjen e zhvilluar me datë 29.01.2022, ora 13:00, sipas rendit të ditës, në ambientët e stadiumit “Luftëtari” Gjirokastër. Në njoftim citohet fakti se mbledhja është bërë, por në kushtet kur nuk kishte kourum pasi janë paraqitur 4 nga 9 anëtarët, mbledhja është shtyrë për me datë 30.01.2022, ora 10:00, planifikuar për t’u zhvilluar në ambientet e hotel “Number one”, Gjirokastër.

Theksojmë faktin se në njoftimin e dërguar anëtarëve të SHRFGJ-së, nga Kryetari i Shoqatës z. Sadik Sadikaj, janë pasqyruar rrethana të rreme dhe ky shtetas duhet të ngarkohet me përgjegjësi penale. Pasi me datë 29.01.2022, nuk është zhvilluar asnjë mbledhje, nuk është kryer asnjë verifikim në lidhje me kourumin, si dhe nuk është marrë asnjë vendim nga anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të SHRFGJ-së. Pasi anëtarët legjitim të shoqatës kanë njoftuar paraprakisht, mospjesmarrjen në mbledhjen e asamblesë.

Ndodhur para këtij fakti, me datë 29.01.2022, një ditë para datës së mbledhjes, 6 nga anëtarët e SHRFGJ-së, nëpërmjet nje emaili zyrtar i kanë kërkuar Kryetarit të Shoqatës z. Sadik Sadikaj, revokimin e vendimit për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

Së fundmi, ne anëtarët e SHRFGJ, jemi njohur me vendimin tuaj të orëve të fundit, për të organizuar dhe zhvilluar ditën e nesërme, në orët e para të ditës, një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të SHRFGJ, e konsideruar qëllimisht nga ana juaj dhe në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 30, të Statutit të SHRFGJ, si Asamble e Përgjithshme e dytë e SHRFGJ, e organizuar brenda 24 orëve, për të cilën nuk kërkohet kuorumi i nevojshëm prej më shumë se 50% e anëtarëve me të drejtë vote.

Një njoftim i tillë dhe vendimmarrja juaj jo statutore për organizimin ditën e nesërme të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të SHRFGJ, është një provë tjetër e faktit që ju, me dashje direkte dhe me kokëfortësi mbresëlënëse, vijoni të kërkonit në shkelje të plotë të ligjit dhe statutit të shoqatës tonë.

Siç dhe ju kemi bërë të qartë më shumë se një herë, shumica e anëtarëve të shoqatës tonë, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre ligjor të njohur nga gjykata shqiptare, nuk merr pjesë në një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të SHRFGJ të thirrur dhe të organizuar në shkelje të plotë të statutit të SHRFGJ, në mungesë të plotë transparence dhe pa respektuar asnjë afat të parashikuar në aktet tona të brendshme rregullatore. Bazuar në këto shkaqe, kemi revokuar paraprakisht çdo autorizim të dhënë për delegatët dhe saktësimin ndaj

jush dhe cilësdo pale tjetër të interesuar, të faktit që ne jemi të vetmit përfaqësues ligjor respektiv të subjekteve tona anëtare të SHRFGJ, që do të përfaqësojnë ato në mbledhjet që do të zhvillojë Asambleja e Përgjithshme e SHRFGJ, duke i paraprirë kështu ripërsëritjes së ngjarjeve të ndodhura në mbledhjet e Asambleve të Përgjithshme të disa SHRF-ve të tjera ku si delegatë janë shfaqur persona të panjohur dhe të paautorizuar nga përfaqësuesit ligjor të Anëtarëve të SHRF-ve.

Duke dashur të shmangim karshi jush çdo pasojë me natyrë penale, ndihemi të detyruar që tu bëjmë me dije paraprakisht faktin që njoftimi i bërë nga ana juaj është tashmë një provë e pakundërshtueshme e faktit penal të falsifikimit të dokumenteve, pasi në njoftimin tuaj paraqitet një rrethanë e rreme, siç është fakti i realizimit të mbledhjes.

Ashtu siç edhe ju jeni fare mirë në dijeni, në datë 29.01.2022, nuk ka ndodhur asnjë mbledhje e Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë. Ky fakt tashmë është i njohur dhe i bërë publik edhe nga vetë ju si Kryetar i SHRFGJ-së dhe FSHF në njoftimin e saj zyrtar.

Për rrjedhojë, në mungesë të zhvillimit të mbledhjes së parë të Asamblesë së Përgjithshme të SHRFGJ, ku të shikohej plotësimi apo jo i kuorunit të nevojshëm prej mbi 50% të anëtarëve të SHRFGJ, ju nuk keni se si të organizoni dhe të konsideroni si një mbledhje të dytë mbledhjen e nesërme të Asamblesë së Përgjithshme të SHRFGJ të thirrur nga ana juaj. Ju bëjmë me dije që, thirrja dhe realizimi nga ana juaj i një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të SHRFGJ-së, nuk mund të bëhet as në trotuar, as në kafene dhe as në furgonat e FSHF-së, por në selinë e SHRFGJ. Ndërkohë që kuorumi i nevojshëm nuk verifikohet nga Kryetari i SHRFGJ-së por nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

Realizimi i një takimi ditën e nesërme, nëpër hotelet e qytetit dhe konsiderimi i këtij takimi si mbledhje e dytë e Asamblesë së Përgjithshme të SHRFGJ-së për të cilën nuk kërkohet kuorumi i nevojshëm i më shumë se 50% të anëtarëve me të drejtë vote, nuk është gjë tjetër veçse përshkallëzim i pasojave të veprës penale të falsifikimit, tashmë të konsumuar nga ana juaj përmes njoftimit të bërë për organizimin e kësaj mbledhje të paligjshme. Sa më sipër, duke ju ritheksuar faktin që tashmë asnjë person tjetër përveç nesh nuk ka tagrin e përfaqësimit të subjekteve tona respektive si anëtare të SHRFGJ, e aq më tepër për të marrë pjesë në takime në hotele shokësh, ju bëjmë me dije vendimmarrjen tonë që, që nesër, përmes studios ligjore të autorizuar nga ana jonë, do të depozitojmë ndaj jush në Prokurori kallëzimin përkatës penal, me akuzën e falsifikimit të dokumenteve, parashikuar nga neni 186/3, i Kodit Penal.

Pavarësisht këtij fakti, rezultoi se me datë 30.01.2022, ora 10:00 ne ambientet e hotel Nr. one është mbajtur mbledhja e anëtarëve të supozuar të Shoqatës Rajonale të Futbollit të Gjirokastrë. Në këtë mbledhje pretendohet se kanë marrë pjesë përfaqësuesit e anëtarëve të kësaj shoqate, 4 nga 9 që janë në total. Këto 15 anëtarë pretendohet se kanë votuar z. Sadik Sadikaj, për kryetar të Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë. Gjithashtu në kundërshtim flagrant me parashikimet statutoare dhe me rregulloren e përgjithshme të asamblesë, disa nga anëtarët prezent jo-legjitim, kanë votuar për zgjedhjen e 4 delegatëve të SHRF Gjirokastrë në Asamblenë e Përgjithshme të FSHF-së.

Rezulton se Vangjel Cavo, administrator i KF Luftëtari, prej më shumë se një viti nuk ndodhet në Shqipëri, si dhe ka autorizuar Altin Çomon që të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të SHRFGJ-së. Ekzistojnë dyshime të arsyeshme së autorizimi është i falsifikuar, në kushtet kur administratori i personit juridik nuk ndodhet në Shqipëri prej disa kohësh dhe kërkojmë të kryhen hetime në drejtim të këtij fakti. Për më tepër sh.a F.K Luftetari është kallzuar në prokurori nga aksioneri i cili zoteron 25 % të aksioneve, Bashkia Gjirokastrë për vjedhje dhe shpërdorim të fondeve etj, përveç kësaj rezulton se **“KF LUFTËTARI” SHA, me NUIS(NIPT) – L63404601H , deri në një urdhër të dytë.**

V-Ne date 09.04.2021: Në bazë të Urdhrit nr. 1689Prot., date 31.03.2021, lëshuar nga shoqëria Përmbarimore “Strati Bailiff’s Service” SHPK, është urdhëruar QKB për: “ Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi aktivet e regjistruara nga pala debitorë “KF LUFTËTARI” SHA me Nipt L63404601H, me administrator Enton Dervishi për ekzekutimin e Vendimit nr. 438, date 28.01.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”

Me veprimet e ndërmara rezulton se kemi të bëjmë haprazi me falsifikim të dokumentave.

Konstatohen shkelje të kundraligjshme në kuadër të zhvillimit të mbledhjes së asamblesë me datë 30.01.2022, konkretisht:

1. Në listën jo të plotë dhe të manipuluar, të vënë në dispozicion para pak kohësh, anëtarëve të shoqatës (personave juridik), me justifikimin për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.
2. Ka informacione që në mbledhjen e datës 29.01.2022, të Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë, me direktivat e dhëna nga Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit Ilir Shulku është kërkuar dhe kanë marrë pjesë në këtë mbledhje persona që nuk kanë asnjë lloj lidhje me shoqatën në kundërshtim të plotë me statutin e federatës që përcakton që delegatet duhet të jenë punonjës të autorizuar nga anëtarët e Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë.
3. Në moszbatimin e procedurës administrative për zhvillimin e mbledhjes së delegatëve, ku në rastin konkret nuk është zbatuar procedura standarte nga Sekretari i Përgjithshëm dhe nga Komisioni i Verifikimit, në lidhje me identifikimin e plotë të delegatëve me të drejtë vote, si dhe lista përkatëse e delegatëve legjitim nuk i është vënë në dispozicion anëtarëve paraprakisht.
4. Zhvillimi i mbledhjes nën kuorumin e nevojshëm, me pjesëmarrjen e 4 anëtarëve të shoqatës nga 9 anëtarë që duhet të jenë, ku anëtarët e tjerë prezent që kanë marrë pjesë në mbledhje kanë qënë persona anonim (delegatë jo-legjitim), konkretisht shtetasi **Neritan Novi** është futur në mbledhje si përfaqësues i Dropullit, kur administrator është **Dhimitraq Shoni**. Duke ju referuar statutit të **SHRFGJ-së, Neni 28, pika 4. Delegatët duhet t'i përkasin anëtarit që ata përfaqësojnë dhe të emërohen ose zgjidhen nga organi i caktuar nga statuti i anëtarit brenda 20 ditëve nga data e Asamblesë së Përgjithshme. Ata gjithashtu duhet të jenë në gjendje ta vërtetojnë këtë gjë. Delegimi i personave jo-anëtarë nuk lejohet**, si dhe ka marrë pjesë

në mbledhje **Petra Meci**, i cili nuk përfaqëson asnjë anëtar të shoqatës dhe nuk është në asnjë pozicion pasi është shkarkuar nga të gjitha funksionet e A.F. LUFTETARI nga bordi drejtues, për më tepër me vendim të bordit i është hequr cdo e drejtë të cilën ka mbajtur më parë. Në këto kushte cmojmë se janë përdorur lista fiktive votuesish, duke falsifikuar nënshkrimet e delegatëve legjitim me të drejtë vote, të cilët kanë kërkuar thirrjen e mbledhjes. Si dhe janë lejuar të marrin pjesë në votim në Asamblesë të Përgjithshme anëtarë jo-legjitim apo persona të paautorizuar, në kundërshtim flagrant me parashikimet statutores dhe me rregulloren e Asamblesë së Përgjithshme.

5. Njoftimet e anëtarëve të Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë janë realizuar nëpërmjet një emaili i cili nuk administrohet nga anëtarët e Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë, por sipas informacioneve, këto emailë janë hapur nga punonjësi të Federatës Shqiptare të Futbollit dhe administrohet po nga ata. Duke futur në këtë mënyrë apo hequr të dhëna në mënyrë të paautorizuar nga sistemi elektronik në administrimin e Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë, me pasoje pavarshmëri dhe vendime të kësaj shoqate. Ndodhur për këtë fakt kërkojmë identifikimin e IP-së (vendodhjes dhe identifikimi i kompjuterit apo njësisë), nga e cila janë dërguar emailët në adresë të anëtarëve të Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë.

Shkeljet nga personat përgjegjës janë bërë me një qëllim të vetëm, ndikimin apo paracaktimin e rezultatit të zgjedhjes së Kreut të Shoqatës së Futbollit të Gjirokastrës, sipas interesave klientelistë të kreut aktual të FSHF-së. Personat përgjegjës në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë kryer veprime të kundërligjshme duke paracaktuar rezultatin e zgjedhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të SHRFK-së, sipas direktivave të drejtuesve të FSHF-së. Kjo përben një shkelje haptazi jo vetëm për këtë proces por për gjithë veprimtarinë e shoqatës, kjo lehtësisht e verifikueshme duke parë të gjitha veprimet nga krijimi i shoqatës deri në veprimet e fundit, të cilat i dëshmojnë me veprime abuzive dhe me shkelje të rënda.

Parashikimet e Statutit të Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë:

Në nenin 25 të Statutit, parashikohen Organet e SHRFKJ-së, konkretisht:

1. *Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë dhe legjislativ.*
2. *Sekretariati i Përgjithshëm është organi ekzekutiv, operacional dhe administrativ.*
3. *Komisionet e përhershme dhe të përkohshme këshillojnë Kryetarin dhe Sekretariatin e Përgjithshëm për përmbushjen e detyrave të tyre.*
4. *Çdo anëtar i organeve duhet të tërhiqet nga diskutimet dhe nga marrja e një vendimi nëse ekziston rreziku ose mundësia e konfliktit të interesit. Në veçanti, anëtarët e organeve duhet të jenë gjithmonë të vetëdijshëm dhe të veprojnë në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Etikës të FIFA-s mbi konfliktin e interesit dhe të rregullojnë sjelljen*

e tyre kur është e nevojshme (p.sh. të abstenojnë nga kryerja 28 Botim Zyrtar 2021 e detyrave të tyre, të njoftojnë kryetarin në rastet e konflikteve të mundshme të interesit, etj.)

Në nenin 27 të Statutit parashikohet se:

1. Asambleja e Përgjithshme është mbledhja ku anëtarët e SHRFGJ mbledhen rregullisht dhe përfaqësohen nga delegatë. Asambleja e Përgjithshme përfaqëson autoritetin më të lartë dhe legjislativ të SHRFGJ-së. Vetëm kur mbledhet sipas rregullave të parashikuara, Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të marrë vendime.

2. Asambleja e Përgjithshme konstituohet në përputhje me parimet e demokracisë përfaqësuese dhe merr parasysh rëndësinë e barazisë gjinore, interesat e futbollit të femrave dhe përfaqësimin e shoqatave të profesioneve të lidhura me futbollin.

3. Asambleja e Përgjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.

4. Asambleja e Përgjithshme kryesohet nga Presidenti, në përputhje me këtë statut, rregulloren e Asamblesë së Përgjithshme, si dhe çdo rregulloreje të zbatueshme.

5. Presidenti i Nderit dhe/ose Anëtarët e Nderit marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme duke u përfshirë në diskutime, por pa të drejtë vote.

Në nenin 28 të Statutit parashikohet se:

Delegatët dhe Votat

1. Asambleja e përgjithshme përbëhet nga anëtarët me të drejtë vote të SHRFGJ-së.

2. Komisioni i verifikimit do të përcaktojë numrin e delegatëve.

3. Delegatët t'i përkasin anëtarit që ata përfaqësojnë dhe të emërohen apo të zgjidhen nga organi i caktuar nga statuti i anëtarit brenda 20 ditëve nga data e Asamblesë së përgjithshme. Ata gjithashtu duhet të jenë në gjendje t'a vërtetojnë këtë gjë. **(Delegimi i personave jo-anëtarë nuk lejohet).**

4. Secili delegat ka të paktën një votë në Asamblenë e Përgjithshme. Për efekt përfaqësimi, cdo anëtar do t'i atribuohet edhe nga një delegat për cdo 100 lojtar të licensuar që marrin pjesë në garat rajonale të të gjitha niveleve. Vetëm delegatët e pranishëm kanë të drejtë vote. Votimi me prokurë ose me letër përfaqësimi nuk lejohet.

Neni 34, pika 2 shkronja p parashikon se:

Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme

Rendi i ditës së Asamblesë së Përgjithshme përmban çështjet e mëposhtme të detyrueshme (në rend kronologjik):

Zgjedhjet e delegatëve që përfaqësojnë SHRFGJ-së në Asamblenë e Përgjithshme të FSHF-së në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Asamblesë së FSHF-së, në përputhje me nenin 3 të rregullores së Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së.

Në nenin 37 të Statutit parashikohet se:

Procesverbali

1. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për mbajtjen e Procesverbaleve të Asamblesë së Përgjithshme.

Në nenin 50 të Statutit parashikohet se:

1. Komisioni i Verifikimit është organi përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e procesit zgjedhor në përputhje me Rregulloren e Asamblesë së SHRFK-së dhe kryerjen e kontrollit të integritetit.

2. Komisioni i Verifikimit përbëhet nga 1 Kryetar dhe 2 anëtarë dhe funksioni i Komisionit të Verifikimit rregullohen nga Rregullorja e Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së dhe FSHF-së.

Në analizë të parashikimeve të dispozitave statutores të referuara si më sipër, cmojmë se z.**Ilir Shulku**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Federatë Shqiptare të Futbollit dhe z.**Sadik Sadikaj** me detyrë Kryetar i Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë, në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë manipuluar procedurat për zgjedhjen e delegatëve, përfaqësues të SHRFK-së, në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së. Me qëllim ndikimin në procesin e zgjedhjes së Kreut të FSHF-së, duke paracaktuar rezultatin.

Gjithashtu vlerësojmë se është e nevojshme të kryhen hetime në lidhje me vendimarrjen e Komisionit të Verifikimit pranë FSHF-së, konkretisht në lidhje me vendimin Nr. 1, datë 10.01.2022, “Për Verifikimin e Numrit të Delegatëve për Futbollin Profesionist, Shoqatat Rajonale dhe Shoqatat e Profesioneve të lidhura me Futbollin në Asamblenë e Përgjithshme të Zakonshme Zgjedhore të FSHF-së”. Cmojmë se ekzistojnë dyshime të arsyeshme për ndikim të jashtëligjshëm në procesin e zgjedhjes së Kreut të FSHF-së, me qëllim paracaktimin e rezultatit, pasi në disa shoqata rajonale para procesit zgjedhor, është shtuar numri i delegatëve dhe në disa prej tyre është reduktuar, pa asnjë shkak të ligjshëm, në kundërshtim flagrant me parashikimet e Statutit dhe Rregullores së Përgjithshme të FSHF-së. kërkojmë kryerjen e veprimeve hetimore në lidhje me procedurën ligjore të ndjekur nga Komisioni i Verifikimit, për caktimin e numrit të anëtarëve të Shoqatës së SHRFK-së.

Pasi në pikën 3, të vendimit të Komisionit të Verifikimit parashikohet: Përcaktimi i numrit të delegatëve të futbollit amator; *Në bazë të parashikimeve të Nenit 28/2/b të statutit, numri i delegatëve që përfaqësojnë futbollin amator përmes shoqatave rajonale do të jetë i barabartë me numrin e delegatëve të futbollit profesionist dhe do të ndahet si vijon: Secila shoqatë rajonale ka të drejtë të ketë një (1) delegat. Delegatët e tjerë do të shpërndahen më pas midis të njëjtave shoqata rajonale në bazë të numrit të përgjithshëm të lojtarëve të regjistruar pjesëmarrës në kampionatet rajonale të të gjitha niveleve. Numri total i lojtareve përfshin lojtaret e regjistruar me klubet pjesëmarrëse në Kampionatin Kombëtar të Kategorisë së Dytë, klubet pjesëmarrëse në Kampionatin Kombëtar të Kategorisë së Tretë; dhe klubet pjesëmarrëse në Kampionatin Kombëtar të Femrave e që nuk janë të përfaqësuara drejtpërdrejtë në një klub sipas pikës 2 të këtij neni. Numri i delegatëve do të rrumbullakoset deri në numrin e plotë më të afërt derisa të gjithë delegatët t’i atribuohen një shoqate rajonale. Bazuar në sa më sipër, duke qenë se numri i klubeve profesionale pjesëmarrëse në Kategorinë Superiore dhe Kategorinë e*

Parë për Sezonin 2021/2022 është në total 26, në bazë të Nenit 28/2 të Statutit të FSHF, numri i delegatëve që përfaqësojnë futbollin amator përmes shoqatave rajonale duhet të jetë i barabartë me numrin e delegatëve të futbollit profesionist. Duke marrë për bazë këto të dhëna (numrin total të lojtarëve të regjistruar me klubet pjesëmarrëse në Kampionatin e Kategorisë së Dytë/Kategorisë së Tretë/Kampionatin Kombëtar të Femrave) përcaktimi i numrit të delegatëve pjesëmarrës në Asambleenë e Përgjithshme të radhës së FSHF për futbollin profesionist, futbollin amator dhe shoqatat e profesioneve të lidhura me futbollin sipas listës së mëposhtme:

- Shoqata Rajonale e Futbollit Shkodër 3 Delegatë
- Shoqata Rajonale e Futbollit Lezhë 3 Delegatë
- Shoqata Rajonale e Futbollit Tiranë 6 Delegatë
- Shoqata Rajonale e Futbollit Durrës 3 Delegatë
- Shoqata Rajonale e Futbollit Elbasan 2 Delegatë
- Shoqata Rajonale e Futbollit Gjirokastrë 3 Delegatë
- Shoqata Rajonale e Futbollit Korçë 2 Delegatë
- Shoqata Rajonale e Futbollit Fier 4 Delegatë

Cmojme se ekzistojnë dyshime të arsyeshme për ndikim të jashtëligjshëm në procesin e zgjedhjes së Kreut të FSHF-së, me qëllim paracaktimin e rezultatit, Pasi në disa shoqata rajonale para procesit zgjedhor, është shtuar numri i delegatëve dhe në disa prej tyre është reduktuar, pa asnjë shkak të ligjshëm, në kundërshtim flagrant me parashikimet e Statutit dhe Rregullores së Përgjithshme të FSHF-së. Kërkojmë kryerjen e veprimeve hetimore në lidhje me procedurën ligjore të ndjekur nga Komisioni i Verifikimit, për caktimin e numrit të delegatëve të Shoqatës së SHRFGJ-së.

Ndodhur para këtij fakti, kërkojmë kryerjen e një hetimi të plotë nga organi i akuzës, në lidhje me identifikimin e plotë të listës së delegatëve pjesëmarrës në mbledhjen e zhvilluar me datë 30.01.2022, për zgjedhjen e delegatëve të Shoqatës së Futbollit të Gjirokastrës. Kërkojmë në mënyrë të menjëhershme sekuestrimin gjithë dokumentacionin e hartuar nga Federata Shqiptare e Futbollit dhe nga Shoqata Rajonale e Futbollit Gjirokastrë, si dhe të gjithë serverat e këtyre dy institucioneve me qëllim sigurimin e provave për faktet penale të referuara dhe ndalimin e vijimit të shkeljeve të mëtejshme që do sjellin si pasoje deformimin kriminal të vullnetit të anetareve të këtyre OJF-ve. Kërkojmë marrjen e masave të menjëhershme dhe ndjekjen penale të shtetasve Ilir Shulku, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Sadik Sadikaj me detyrë Kryetar i Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë, si personat përgjegjës për administrimin e dokumentacioni elektronik dhe fizik të institucioneve që përfaqësojnë.

LIGJI I APLIKUESHËM

Kodi i Procedures Penale, ne nenet e tij 280 dhe 283 parashikon se:

Neni 280

Marrja dijeni për veprën penale

Prokurori dhe policia marrin dijeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.....

Neni 283

Çdo person që ka marrë dijeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.....

Nga ana tjetër Kodi Penal në nenin 186 parashikon se: *Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet.*

Neni 186/a i Kodit Penal parshikon se: *“Futja, ndryshimi, fshirja apo heqja e të dhënave kompjuterike, pa të drejtë, për krijimin e të dhënave të rreme, me qëllim paraqitjen dhe përdorimin e tyre si autentike, pavarësisht nëse të dhënat e krijuara janë drejtpërdrejt të lexueshme apo të kuptueshme, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në gjashtë vjet.”*

Objekti i kesaj vepre penale jane mardheniet juridike te vendosura per te siguruar veprimtarine e rregullt te administrates publike, te organizatave, firmave te mbrojtura posacerisht nga legjislacioni penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive, vepra penale kryhet ne dy forma kryesore:

- a) me ane te falsifikimit te dokumentave, ndryshim identiteti, moshes etj.
- b) me perdorimin e dokumenteve te falsifikuara...

Referuar praktikes gjyqesore qendrimi i Kolegjit Penal te Gjykates se Larte ne lidhje me kete veper penale shprehet se: vepra penale e falsifikimit te dokumentave nuk kerkon i element te saj vetem qellimin e fitimit, por mjafton qe te pasqyrohen ne to te dhena te paverteta. Vepra penale e falsifikimit te dokumentave kryhet ne rrethana cilsuese:

- a) bashkepunim
- b) kur kryhet me shume se nje here.
- c) kur falsifikimi ka sjell pasoja te renda, rastet kur falsifikimi eshte bere me shumice.

Subjekt i vepres penale, eshte cdo person qe ka mbushur moshen per pergjegjesi penale dhe eshte i pergjegjshem, i cili falsifikon dokumentin.

Nga ana subjektive, vepra penale e falsifikimit të dokumentave apo përdorimit të dokumentave të falsifikuar kryhet vetëm me dashje direkte, do të thotë se i pandehuri me dashje bën ndryshime të pjesshme ose falsifikon tërësisht të dhënat në dokument, ose e përdor dokumentin e falsifikuar duke e ditur që ai dokument është i tillë.

2. Nga ana tjetër Kodi Penal në nenin 248, parashikon se:

Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.

Që të jemi përpara rastit të konsumimit të një veprë penale, duhen analizuar këto elemente të figurës së veprës penale: **objekti, ana objektive, subjekti, ana subjektive**. Që të konkludohet se të një subjekt ka konsumuar veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” duhet që të evidentohet pikë së pari ekzistenca e të gjithë elementëve të kësaj figure veprë penale, në veprimet e tij. Ashtu siç trajtohen në teorinë e së drejtës penale materiale, elementët e veprës penale janë katër, objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive, të cilët duhet të bashkëekzistojnë njëkohësisht në mënyrë që një person të merret në përgjegjësi penale.

Referuar nenit 248 të K. Penal, ligjvënasi ka parashikuar mbrojtje të posaçme për marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti me ligj apo me akte nenligjore për të siguruar veprimtarinë normale të aparatit shtetëror si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve ose shtetit; cenimi i të cilave pasqëllë për gjegjësi penale. Nga interpretimi i dispozitës së mesipërme arrijmë në përfundimin se legjislatori, marrëdhëniet që kanë të bëjnë me përmbushjen e rregullt zbatimit të ligjeve, si dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve, i ka cilesuar si marrëdhënie juridike të rëndësishme, të cilat mbrohen posaçërisht nga legjislati i penal.

1. Objekt i veprës penale, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, janë mbrojtja e marrëdhënieve juridike të parashikuara me ligj ose në aktet nenligjore për të siguruar veprimtarinë normale të aparatit shtetëror, si dhe mbrojtjen dhe interesat e ligjshme të shtetasve ose të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislati i penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

2. Nga ana objektive, krimi i shpërdorimit të detyrës kryhet me veprime aktive të kundërligjshme ose moskryerjen e veprimeve që përben mospërmbushje të rregullt të detyrës. **Për krimin e shpërdorimit të detyrës është element i domosdoshëm i anës objektive është konstatimi i lidhjes shkakësore të drejtepërdrejte midis veprimit dhe**

mosveprimi të kundraligjshëm, mospermbushje e rregullt e detyres dhe demtimit të interesave të ligjshme të shtetit, shtetasve dhe të personave të tjere juridik.

Duke ju referuar interpretimit literal të dispozites dhe praktikës gjyqësore, elementet objektive të kësaj veprë penale janë:

- a) Kryerja ose moskryerja e veprimeve në kundërshtim me ligjin,
- b) veprimet ose mosveprimet përbejnë mospermbushje të rregullt të detyrës,
- c) veprimet ose mosveprimet kryhen nga një person që ushtron funksione publike,
- d) veprimet ose mosveprimet i kanë sjellë personit ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale ose kanë demtuar interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave juridike,

3. Subjekt i kësaj veprë penale, mund të jetë subjekt i posaçëm, çdo punonjës i ngarkuar me funksion publik. Referuar ligjit të sportit, sporti në Republikën e Shqipërisë është një veprimtari me interes publik në Republikën e Shqipërisë dhe shteti e ka deleguar këtë funksion publik tek Federatat Sportive (neni 7 dhe neni 17 i ligjit nr. 79/2017 “Për Sportin në Republikën e Shqipërisë”).

4. Nga ana subjektive, vepra penale e shpërdorimit të detyrës kryhet kurdoherë me dashje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndaj veprimeve ose mosveprimeve dhe me pakujdesi ndaj pasojave të ardhura.....

Për sa parashtrua më sipër, vërtetohet qartësisht se me veprimet e ndërmarra nga shtetasi Ilir Shulku me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit dhe shtetasit Sadik Sadikaj me detyrë Kryetar i Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë, janë konsumuar elementët e figurave të veprave penale të sipërcituara dhe ky shtetas duhet të ngarkohet me përgjegjësi penale. Këtij kallëzimi do i bashkëngjisim edhe provat mbështetëse të cilat do të vërtetojnë pretendimet e bazuara, në cilësinë e palës kallëzuese.

Për sa më sipër, i kërkojmë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, regjistrimin e procedimit penal për veprat penale “*Falsifikimi i dokumentave*”, “*Shpërdorim detyrë*”, “*Ndërhyrje në sisteme kompjuterike*” dhe “*Falsifikimi kompjuterik*” parashikuar nga nenet 186, 248, 293-c, 186-a të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Ilir Shulku me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit dhe shtetasit Sadik Sadikaj me detyrë Kryetar i Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastrë.

Kallzues

A.F. Luftëtari

Përfaqësuar nga z. Fotis Kristidhi (Administrator) dhe z. Nertil Nebiaj (Anëtar i Bordit)

